



THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME

PROGRAMI MBËSHTETJE PËR
ZHVILLIMIN E BIZNESIT
ME FONDE PËR VITIN 2024

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve hap thirrjen për mbështetjen dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), për vitin 2024.

AIDA administron fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve”, sipas përcaktimeve të nenit 11, shkronja a, të ligjit nr. 43/2022 “Për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme”, i cili financohet nga buxheti i shtetit.

Kjo thirrje mbështet zhvillimin e NMVM-ve duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin/rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm. Kjo thirrje synon mbështetjen e NMVM-ve që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të vendit.

Projekt -propozimet e paraqitura nga NMVM-të duhet t'i përmbahen kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për NMVM për vitin 2024.

Drejtimet e Thirrjes për mbështetjen financiare nga Programi “Mbështje për Zhvillimin e Biznesit” janë:

**MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR
ZHVILLIMIN E
AKTIVITETEVE**

**MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR
INVESTIME**

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE

Vlera e financimit deri në **2.500.000 ALL**

Mbulimi i kostove **100%**

Kostot e mbulueshme:

- Çertifikimi i standardeve të prodhimit/ shërbimit (*përfshirë dhe konsulencën përkatëse*);
- Pjesëmarrje në trajnime për rritje kapacitetesh;
- Pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare me stenda të gatshme;
- Promovimi i markës përmes digjitalizimit;
- Krijimi dhe ndërtimi i aplikacioneve dhe/ ose platformave për e-Commerce;
- Përgatitje të materialeve promovuese (*jo më shumë se 20% e vlerës totale të projektit*);

Dokumentat per aplikim:

- Formular aplikimi (*Format i gatshëm nga AIDA; shkarkohet në web*);
- Formular Buxheti (*Format i gatshëm nga AIDA; shkarkohet në web*);
- QKB;
- Deklarata për kategorinë e NMV (*Format i gatshëm nga AIDA*);
- Vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore + sigurimet shoqërore & shëndetësore (*E-Albania*);
- Vërtetim dogane (*për subjektet eksportuese; E-Albania*);
- Bilanc i vitit të fundit (*2023*);
- Mjet identifikimi për administratorin e kompanisë;
- Dëshmi penaliteti për drejtuesin ekzekutiv/administratorin (*E-Albania*);
- Çdo document tjetër shoqerues, që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR INVESTIME

PROJEKTE PËR INOVACIONIN

Vlera e financimit deri në **1.000.000 ALL**

Mbulimi i kostove **100%**

Kostot e mbulueshme:

- Zhvillim/ përmirësim teknologjik i produktit;
- Blerje aplikacioni për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash;
- Blerje aplikacionesh dhe/ose programe apo paketa të ndryshme kompjuterike.

PROJEKTE PËR KONKURRUESHMËRINË

Vlera e financimit deri në **1.500.000 ALL**

Mbulimi i kostove **100%**

Kostot e mbulueshme:

- Blerje makinerive dhe/ose pajisjeve të punës që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së produktit.

PROJEKTE PËR START-UP

Vlera e financimit deri në **800.000 ALL**

Mbulimi i kostove **100%**

Kostot e mbulueshme:

- Blerje makinerive dhe/ose pajisjeve të punës;
- Blerje e aplikacioneve dhe/ose programeve të e-commerce.

PROJEKTE PËR ARTIZANATIN

Vlera e financimit deri në **800.000 ALL**

Mbulimi i kostove **100%**

Kostot e mbulueshme:

- Blerje makinerive dhe/ose pajisjeve të punës tradicionale dhe/ose teknologjike;
- Blerje e aplikacioneve dhe/ose programeve të e-commerce.

Dokumentat per aplikim:

- Formular aplikimi (*Format i gatshëm nga AIDA; shkarkohet në web*);
- Formular Buxheti (*Format i gatshëm nga AIDA; shkarkohet në web*);
- QKB;
- Deklarata për kategorinë e NMV (*Format i gatshëm nga AIDA*);
- Vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore + sigurimet shoqërore & shëndetësore (*E-Albania*);
- Vërtetim dogane (*për subjektet eksportuese; E-Albania*);
- Bilanc i vitit të fundit (2023);
- Mjet identifikimi për administratorin e kompanisë;
- Dëshmi penaliteti për drejtuesin ekzekutiv/administratorin (*E-Albania*);
- Çdo document tjetër shoqerues, që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

*Thirrja për projekt-propozime do të qëndrojë e hapur **30 (tridhjetë) ditë** kalendarike nga data e publikimit të saj, data 12 korrik 2024.*

*Projekt – propozimet e paraqitura nga NMVM-Të duhet të realizohen brenda vitit buxhetor që do të thotë se aktivitetet e propozuara duhet të zhvillohen brenda periudhës **Tetor – Dhjetor 2024.***

VËMENDJE: *Aplikantët do të paraqesin **VETEM 1 (një)** projekt – propozim në një nga drejtimet e thirrjeve.*

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave do të kryhet nëpërmjet adresës elektronike: ndermarrje@aida.gov.al



Address:

Skerdilajd Llagami St. Building no.1 Tirana, Albania

Website: www.aida.gov.al | **Email:** info@aida.gov.al | **Tel:** +355 042 251001